

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZONI PENAL, Gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fatmire Podvorica dhe bashkëpunëtoreshen profesionale Valbonë Fejza në çështjen penale kundër të akuzuarit Xh.S. me vendbanim në F.K., rr:”...”, objekti 16, Hyrja 2, nr.22 për shkak të veprës penale Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.4709/17 e dt.25.05.2018 pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 21.01.2019 në praninë e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore nga Prishtina-Ali Ajdini, të dëmtuarit R.L. dhe të akuzuarit, të njejtën ditë mori dhe shpalli, ndërsa me dt.23.01.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

XH.S., nga i ati S. dhe nëna S., mbiemri i vajzërisë së nënës I., i lindur më *data e lindjes...*, me vendbanim në F.K., rr:”...”, objekti 16, Hyrja 2, nr.22, deklaroi se ka të kryer fakultetin Elektroteknik, me profesion inzhinier, me numër personal të identifikimit *numri personal...*, i gjendjes së mirë ekonomike-financiare, sipas evidencës penale të kësaj gjykate i njëjti nuk ka qenë i gjykuar më parë dhe ndaj tij nuk ka të dhëna se zhvillohet procedurë tjetër penale, i martuar baba i 4 fëmijëve, Shqiptar-Kosovar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me dt.04.08.2017, rreth orës 08:30 minuta në pikën kufitare në M., Komuna e P. i pandehuri i mllefosur për shkak të mos lejimit të kalimit të kufirit nga ana e autoriteteve serbe, ishte kthyer prapë tek autoritetet kosovare për të kërkuar sqarime dhe pasi që Policia e Kosovës i kishin thënë se Serbia i ka ligjet e veta dhe nuk e dijnë arsyen e kthimit të tij, ai kishte filluar ta ofendoj me fjalë banale zyrtarin policor-tani të dëmtuarin R.L. i cili për ta qetësuar të pandehurin e kishte ftuar që të shkojnë në Zyrën e Doganës për të biseduar, pastaj i pandehuri me dashje sapo ka hyrë në zyre të Doganës e ka goditur me grushta mbrapa në krahëror zyrtarin policor-të dëmtuarin R.L. i cili ishte duke e kryer detyrën zyrtare, ku si pasojë e goditjes i dëmtuari ishte rrëzuar dhe i njëjti ka pësuar lëndime të lehta trupore si ndrydhje, gërvishtje dhe enjtje në regjionin e gishtit të madh të dorës së majtë dhe enjtje në gishtin e pestë të dorës së djathtë, me pasojë të përkohshme të shëndetit.

Me këtë ka kryer veprën penale Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 73, 74, 410 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 366, 369, 370, 453, 463 të KPPRK-së, e:

G J Y K O N DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të akuzuarit Xh.S. i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti nuk kryen veprë të re penale, nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 20.00€ për ekspertizë mjeko-ligjore, në emër të shpenzimeve paushalle të paguaj shumën prej 20.00€ si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30.00€, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

I dëmtuari R.L. nga fshati Ll., Komuna e P. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.4709/17 e dt.25.05.2018 kundër të akuzuarit Xh.S. me vendbanim në F.K., rr:"...", objekti 16, Hyrja 2, nr.22 për shkak të veprës penale Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 19.11.2018, seancën e shqyrtimit të dytë me datë 19.12.2018 si dhe seancën e shqyrtimit gjyqësor me datën 21.01.2019 në të cilën ka prezentuar Prokurori i Shtetit Ali Ajdini nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, i dëmtuari R.L. dhe i akuzuari Xh.S.

Prokurori i shtetit Ali Ajdini në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se: Me provat e shqyrtuara në shqyrtimin gjyqësor e sidomos me deklaratat e dëshmitarëve, me ekspertizën mjeko-ligjore dhe me foto-dokumentacionin që gjendet në shkresat e lëndës është vërtetuar se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha elementet qenësore të veprës penale Sulm ndaj personit zyrtar nga neni 410 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së. Po ta analizojmë mbrojtjen e të pandehurit e njejta është konfuze, kontradiktore dhe nuk argumenton të kundërtën e asaj që thuhet në aktakuzë prandaj mbrojtjes së tillë gjykata nuk duhet t'ia fal besimin dhe si të tillë duhet ta hudhi poshtë. I propozon gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të njejti ta dënoj sipas ligjit.

I dëmtuari R.L. në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se nuk parashtron kërkesë pasurore-juridike dhe i propozoj gjykatës që të veprojnë sipas ligjit.

I akuzuari Xh.S. në seancën e shqyrtimit gjyqësor veç të tjerash deklaroi: Se nuk është e vërtetë se unë i kam sharë zyrtarët policorë të Kosovës, nuk është e vërtetë se unë e kam goditur zyrtarin policor të Kosovës dhe unë as sot nuk e dij pse jam kidnapuar nga personat në fjalë. Gjatë shqyrtimit gjyqësor dëshmitarët kishin tregime të ndryshme për rastin kjo tregon se ngjarja nuk ka ndodhur ashtu që unë të kem sulmuar personin zyrtar, sepse kete nuk e kam bërë as në foshnjore sipas tregimeve të mësueses së foshnjores e cila është e gatshme me qenë dëshmitare, shpresoj se pas të gjitha këtyre dëshmimeve dhe fakteve unë do të lihem i lirë dhe nuk do të maltretohem siç jam maltretuar prej fillimit, kidnapimit e deri në këtë moment.

Kjo gjykatë konsideron se përtej çdo dyshimi pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor vërtetoi këtë gjendje faktike: I akuzuari i mllefosur për shkak të mos lejimit të kalimit të kufirit nga ana e autoriteteve serbe, kthehet tek autoritetet kosovare për të kërkuar sqarime dhe kishte filluar ta ofendoj me fjalë banale zyrtarin policor-tani të dëmtuarin R.L. i cili për ta qetësuar të pandehurin e kishte ftuar që të shkojnë në Zyrën e Doganës, pastaj i pandehuri me dashje e ka goditur me grushta mbrapa në krahëror, ku si pasojë e goditjes i dëmtuari ishte rrëzuar dhe i njejt ka pësuar lëndime të lehta trupore si ndrydhje, gërvishtje dhe enjtje në regjionin e gishtit të madh të dorës së majtë dhe enjtje në gishtin e pestë të dorës së djathtë, me pasoja të përkohshme të shëndetit.

Këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoi pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor, nga deklarata e të dëmtuarit-dëshmitarit R.L., dëshmitarit B.B., Raporti mjekësor me numër të protokollit 977 i datës 04.08.2017 lëshuar nga Qendra Kryesore e Mjeksisë Familjare në P., Akt-ekspertimi mjeko-ligjor me numër të referencës PR-330 të datës 03.09.2017 i përpiluar nga Dr.N.U., si dhe foto-dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës.

Në shqyrtimin gjyqësor publik në këtë çështje penale, këto prova lartcekura gjykata konform nenit 8 par.1 dhe 2, si dhe nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet dhe provat në shqyrtim gjyqësor që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje përkushtim maksimal e profesional dhe me ndërgjegjeje vlerësoj çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, si dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

I dëmtuari-dëshmitari R.L. në seancën e shqyrtimit gjyqësor deklaroi: Se me dt.04.08.2017 fillova punën sipas orarit, rreth orës 08:30 ka ardhur një qytetar i nervozuar ndaj policëve serb në pikën kufitare në M. meqenëse të njejt nuk e kanë lejuar që të kaloj pikën kufitare, ishte shumë i mllefosur dhe shumë i nervozuar sa që ka filluar të më ofendoj edhe mua personalisht në mënyrën më banale duke më ofenduar edhe familjen, e kam sygjerruar që mos të shprehet në atë mënyrë ndaj askujt, pas kësaj e kam thirr të largohet nga vendi publik sepse aty kishte shumë njerëz, gra, fëmijë, pleq dhe të hyjmë në objektin e doganës dhe i njejt pranoi. Në objektin e doganës kemi qenë duke hyrë unë, i pandehuri dhe kolegu im zyrtari policor- B.B. dhe papritmas nga mrapa jam goditur nga i pandehuri me boks në pjesën e majtë të shpinës dhe si pasojë e goditjes unë kam rënë mbi një tavolinë pune të doganës dhe mu pranë saj ka qenë një nxemëse sa që më kanë hyrë dy duart në nxemje dhe kam rënë në dysheme, derisa unë jam ngritur në këmbë e kam parë kolegun tim që ka tentuar ta fut nën kontroll të pandehurin dhe pas kësaj bashkë e kemi futur nën kontroll dhe e kemi shoqëruar në zyret tona të policisë ku për të njejtin është hapur rast. Kontakti i parë mes meje dhe të pandehurit ka ndodhur në vendin e punës time dhe të pandehurin e kemi arrestuar në mënyrë ligjore dhe e kemi shoqëruar për duarsh deri në zyrën e policisë në pikën kufitare në M.

Dëshmitari B.B. në seancën e shqyrtimit deklaroi: Se me datën 04.08.2017 isha në detyrë duke i marrë dokumentat për kontrollë vozitësve dhe pasagjerëve të veturës për ti regjistruar në sistem në drejtim të daljes nga Republika e Kosovës në Republikën e Serbisë. Kolegu im R., ka qenë në drejtimin e hyrjes nga Republika e Serbisë, në ndërkohë kam dëgjuar fjalë të ashpra nga një palë që ishte duke hyrë në Kosovë dhe kam vrapuar për të asistuar në konflikt. R. është munduar që ta qetësoj duke ja sqaruar situatën mirëpo i njejtë nuk dëgjonte dhe vetëm bëhej më agresiv, kur kemi qenë duke hyrë brenda në zyre të Doganës i pandehuri e ka goditur R. nga mbrapa dikun në shpinë dhe R. ka filluar të bjen në tokë, unë u mundova që të pandehurin ta tërheq mbrapa dhe ta qes jashtë mirëpo ishte e kotë ngase ai filloi edhe mua të më tërheq, unë e kam mbështetur me shpinë për tavoline e kam mbajtur derisa është ngritur në këmbë R., pastaj e kemi prangosur dhe e kemi dërguar në zyrën e kujdestarisë për iniciimin e procedurës, i njejtë ka vazhduar me fjalë fyese ndaj nesh.

Nga Raporti Mjekësor me numër protokollit 977, i datës 04.08.2017 i lëshuar nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në P., vërtetohet se i dëmtuari R.L. është dërguar për kontrollë mjeksore në këtë qendër në shoqërimin e policisë ku janë konstatuar lëndimet e pësura nga mjeku kujdestar Dr.B.H.

Nga Akt-ekspertimi Mjeko-ligjor i Dr. N.U. me numër reference Pr-330 i datës 03.09.2017, vërtetohet se i dëmtuari R.L. ka pësuar dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme në shëndet si rezultat i veprimit mekanik të mjetit të fortë, mbretës (jo të mprehtë).

Nga foto-dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës vërtetohet se zyrtari policor R.L. në vendin e tij të punës ka pësuar lëndime si ndrydhje, gërvishje dhe enjtje në regjionin e gishtit të madh të dorës së majtë dhe entje në gishtin e pestë të dorës së djathtë.

Gjykata në mënyrë të hollësishme analizoj edhe mbrojtjen e të akuzuarit Xh.S. duke e hedhur poshtë si të pa bazuar dhe në kundërshtim me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe duke e vlerësuar si përpjekjeje për ti ikur përgjegjësisë penale.

Pas administrimit dhe vlerësimit të provave në shqyrtimin gjyqësor, gjykata sipas bindjes së lirë vërtetohet gjendjen e plotë dhe të drejtë faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ju dhënë besimin e plotë deklaratës së të dëmtuarit-dëshmitarit R.L., dëshmitarit B.B., Raporti mjekësor me numër të protokollit 977 i datës 04.08.2017, Akt-ekspertimi mjeko-ligjor me numër të referencës PR-330 të datës 03.09.2017, si dhe foto-dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës dhe të gjitha këto prova janë bindëse nga se ndërlidhen njëra me tjetrën se i akuzuari Xh.S. vërtet e ka kryer veprën penale Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarit, kështu që i njejtë është penalisht përgjegjës.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, për të cilën veprën penale gjykata edhe e shpalli fajtor dhe e dënoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 dhe 74 të KPRK-së dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari për herë të parë ka rënë në kundërshtim me ligjin, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata gjeti mënyrën e kryerjes së veprës penale, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur siç është jeta dhe shëndeti trupor i njeriut, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale prandaj gjykata duke i vlerësuar këto rrethana ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në përputhje me peshën e veprave penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, rrethanat në të cilat janë kryer veprat penale, gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandaloj nga kryerja e këtyre veprave penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të gjitha këto të parapara me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.1. dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së, si dhe vendimi në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit është marrë në bazë të nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, me nr.05/L-036.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
P.nr.368/2018, dt.21.01.2019

Sekretare Juridike
Fatmire Podvorica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Minir Hoti

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrajnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.